

PROCES-VERBAL

Dëgjuesë Publike: Njësia Administrative Suç

Datë 29.10.2020, ora 13.00

Marrin pjesë Kryetari i Bashkisë, Nënkyetarja e Bashkisë, Nënkyetari i Bashkisë, Drejtori i Shërbimeve dhe Infrastukturës, Përgjegjësjë e Sektorit të Financës, Administratori i Njësijë Administrative Suç, Përgjegjësjë e Zyrë së Planifikimit dhe Ndjekjes së Investimeve.

Hap mbledhjen Kryetari i Bashkisë Z. Ilmi Hoxha

Falenderon pjesëmarrësit dhe prezanton stafin që e shoqëron. Qëllimi i takimit është për të diskutuar rreth projekt-buxhetit dhe paketës fiskale të vitit 2021. Paketa fiskale mund të këtë nevojë për ndryshime. Fatkeqësisht jemi një nga Bashkitë që jemi prekur nga tërmeti. Kemi harxhuar kohë dhe burime njerëzore gjatë kësaj kohe. Gjithashtu kemi harxhuar kohë për masat që janë marrë në lidhje me pandeminë. Deri me date 23.06.2020 ka qene e bllokuar puna me thesarin pëe shkak të pandemisë. Flet për pakot ushqimore që janë shpërndatë gjatë periudhës së pandemisë dhe që kanë qenë falë kontributit të qytetarëve dhe të bizneseve. Tregon që kemi marrë investime nga Bashkimi Evropian në lidhje me ndërtimin e Muzeut.

Sot jemi për të marrë kërkesat tuaja kryesore që ti projektojmë për vitin 2021 dhe ti realizojmë ato.

Tregon që në këtë njësi administrative i është dashur të merret me çështjen e shkollës së Suçit, e cila ka nevojë për investim.

Në lidhje me kanalet e ujit vaditës tregon menaxhimin e mirë që është bërë gjatë këtij viti. Probleme kemi hasur në Kurdari për shkak të konflikteve mes banorëve për ujin vaditës.

Merr fjalën Përgjegjësjë e Sektorit të Financës Znj. Silvana Bala:

Paraqet në mënyre të shkurtuar buxhetin e vitit 2020 në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara dhe paraqet transfertat e pakushtëzuara, sektoriale, të kushtëzuara dhe të ardhurat e planifikuara për vitin 2021.

Më pas merr fjalën Mazllam Çeliku dhe pyet çfarë është bërë në lidhje me ndërtimin e KUZ në Kurdari.

Kryetari e sqaron që është hartuar projekti dhe që do të realizohet me buxhetin e vitit 2021.

Flet Melazim Hystuna në lidhje me rrugën e Kurdarisë dhe kërkon që të vendoset tabela për kapacitetet që duhet të mbajë makina.

Merr fjalën Shefki Axha(f.Kujtim)

Shpreh falenderim në lidhje me takimin e organizuar , për pjesëmarrjen dhe për punët e realizuara.

Flet për problemet në lidhje me ujin vaditës

Merr fjalën Nazmi Axha (f.Kujtim)

Falenderon për pjesëmarrjen dhe punët e realizuara dhe shpreh shqetësim për pyjet e fshatit Kujtim.

Flet Ferit Budini

Shpreh shqetësimin në lidhje me shkollën e Suçit.

Kryetari i tregon që është realizuar projekti dhe do të ndërtohet në të njëjtin vend ku ndodhet tani.

Banorët Bujar Hystuna dhe Fran Pjetri shprehen që Suçi ka problem me azhornimin e tokës.

Sqaron Kryetari që kjo është zgjidhur nga ligji 20/2020 dhe kërkesa e Administratorit.

Gjithashtu duhet ndërhyrja në Drejtorinë Rajonale të Kadastrës dhe në Ministri dhe duhet filluar direkt me letrat.

Flet Nënkryetari Z.Armand Gjini I cili shpjegon ligjin 20/2020.

Merr fjalën Liman Laçi dhe kërkon shpjegim në lidhje me transfetën dhe të ardhurat që mblidhen.

Flet për nr.te lartë punonjësish, si dhe kërkon roje te depot e Allamanit për ujin e pijshëm.

Kryetari sqaron në lidhje me transfetën dhe të ardhurat dhe i thotë që kërkesa në lidhje me rojet e depove bie në kundërshtim me ankesën për nr.te lartë punonjësish.Nqs do vendosim roje nëpër depo duhen shtuar edhe shumë punonjës.

Merr fjalën Ilir Topalli:

Flet për problemet e ujit vaditës për fshatin Kujtim, gjithashtu paraqit ankesën pse uji i pijshëm nuk i ka shkuar deri në shpi nga investimi që është bërë.

Sqaron Përgjegjësja e planifikimit dhe ndjekjes së investimeve që në lidhje me projektin e ujësjellësit të Suçit, detyra e firmës ka qenë ta çojë ujin deri te puseta qendrore, por falë vullnetit të Kryetarit në bashkëpunim me firmën e zbatuesit do të realizohet dërgimi i ujit nëpër shtëpi.Banorët Flamur Keçi dhe Lirim Patlli flasin në lidhje me rezervuarin e Kurdarisë.

Kryetari mbyll takimin duke falenderuar pjesëmarrësit për ato cka paraqitën në takim dhe kërkon bashkëpunim të mëtejshëm.

Përgjegjëse e Sektorit të Financës

Silvana Bala

